

BAHRI ALIU

TRYEZA E RRUMBULLAKËT

FUNDAMENTALIZMI ISLAM – ÇKA ËSHTË KY?

Më 13 janar 1990 në Sarajevë në organizimin e revistës “Preporod” dhe “Islamska Misao” u mbajtë tryeza e rrumbullakët në temën **“Fundamentalizmi Islam – çka është ky?”** Tryeza u mbajtë në amfiteatrin e Fakultetit teologjik islamik në të cilën morën pjesë shkencëtarë të disiplinave të ndryshme si: islamologë, teologë, sociologë, filozofë, politologë, publicistë etj., nga tërë Jugosllavia.

Tubimi në fjalë ngjalli interesim të posaçëm te të pranishmit pasi që për herë të parë mbahet një Tryezë e rrumbullakët e këtij lloji në vendin tonë. Interesim të veçant treguan teistët, ateistët dhe plitologët pasi që qëllimi kryesor i këtij tubimi, siç përmendi kryesuesi i këtij tubimi, prof. Hilmo Neimarlija, ligjërues në Fakultetin teologjik islamik, ishte të ndriçohet termi **“fundamentalizëm”** në mënyrë të gjithanshme.

Gjithashtu në Traezën e rrumbullakët morën pjesë: Ushtruesi i Reisit për RSFJ h. Jakub ef. Selimovski, kryetarët e BI-ve republikane dhe Sekretari i Komisionit për çeshtje fetare në BeH zotëzi Filip Shimiqi.

Shumica e pjesëmarrësve shprehën kënaqësinë që marin pjesë në një tubim kaq të rëndësishëm dhe falenderuan organizatorët, sidomos Bashkësinë Islame për një hap të këtillë duke dëshiruar që kjo inisiativë të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe të tubojë sa më shumë dijetarë dhe studiues të cilët do të kontribuonin në ndriçimin objektiv të çeshtjeve të parashtruara.

Me rëndësi është të përmendet se Tryezën e rrumbullakët e ndoqën mbi 30 gazetarë nga 22 redaksi të ndryshme të vendit dhe RTV i Sarajevës.

Tryeza e rrumbullakët u hap me leximin e një ashereje nga Kur’ani Kerimi pastaj mori fjalën kryesuesi i Tryezës së rrumbullakët ligjëruesi i Fakultetit teologjik islamik i cili bëri një ekspozitë të shkurtër për qëllimet dhe motivet e këtij tubimi në temën **“Fundamentalizmi Islam – çka është ky?”** duke definuar termin **“fundamentalizëm”** dhe mnëyrën se si dhe pse përdoret ky term në shkrimet e sotme tek ne dhe më gjërë.

Hilmo Neimarlija në mes tjerash tha se “për fundamentalizmin islam mund të bisedohet si paraqitje empirike e që është aktuale në botën islame. Rreth fundamentalizmit islam mund të bisedohet si formë dhe formulacion i Perëndimit për veçoritë dhe aspiratat e Islamit. Gjithashtu mund të flitet në kuptim simbolik duke unifikuar disa fenomene të ndryshme në vetë Islamit dhe rreth tij. Për fundamentalizmin islam mund të flitet gjithashtu si një stereotip të fazës operative e cila shfrytëzohet për të përcaktuar domethënien e tij e në të shumtën e rasteve i jepet një kualitet ose një kundërkualitet. Në rrethanat tona për fundamentalizmin islam mund të flitet si prallë ose si fantom i pashembullt përmes së cilës orvatemi të shqetësojmë somuslimanët ndërsa në të njëjtën kohë të provokojmë muslimanët.”

Nusret Çançar duke dëshiruar që të përkufizojë domethënien terminologjike të fjalës **fundamentalizëm** dhe përdorimin e saj në shkencat e krijimtarisë shpirtërore dhe intelektuale të njeriut gjatë historisë pamëdyshje është thirrja në themelet dhe burimet e disa njohurive për të cilat njeriu merr vendin si qenie historike dhe tradicionale. Mirëpo, për njeriun, një qëndrim i këtillë ndaj botës nuk është sipas dëshirës së tij, përkundrazi themi se ajo është dhënti...” Nusret Çançari në vazhdim **“fundamentalizmin”** si paraqitje e analizon historikisht dhe thotë: “Në orientalistikën evropiane tek disa autor bëhet edhe diferencimi i terminologjik dhe përcaktojnë dy lloje të marrëdhënieve ndaj traditës dhe bñurimeve Islame.

Lloji i parë nënkupton kthimin e nevojshëm burimeve të fesë në praktikë dhe gjeneratës sëparë muslimane si shembull i cili na shërben për mësim dhe të përforcojmë besimin. Ky lloj i marrëdhënieve përcaktohet si fundamentalizëm teorik të cilin e posedon çdo religjion pa të cilin nuk mund të ekzistojë. Sipas këtij kuptimi, nëse dikush sinqerisht do të jetë i tillë, atëherë deshtepadesht janë fundamentalist sepse duhet të aplikojë bazat e fesë së vetë si p. sh. veç ashtu siç i përmend Kur’ani Famëlartë dhe siç i praktikoi Pejgamberi a.s. në jetën e përditshme.

Lloji i dytë i marrëdhënieve sipas traditës Islame nënkupton bindjen se modeli i Bahskësisë Islame institucionalisht ka ndodhur qysh në “kohën e artë të Islamit”, dëshmitarë të së cilës ishin gjenerata e parë e muslimanëve (ehlu selefi) dhe principi i drejtësisë, humanitetit dhe moralitetit islam mund të arrihet vetëm përmes restaurimit të atij modeli. Lloji i dytë quhet **revivalizëm**, përjetim i përgjithshëm i modelit i cili veç ka ndodhur gjatë historisë.”

Fundamentalizmi në aspektin e sheriatit

Dr. Fikret Karçiçi duke analizuar temën në fjalë në aspektin e sheriatit në mes tjerash parashtrroi pyetjen se si do të definojmë Islamin si “besim dhe drejtësi” (akide ve sheria), “fe dhe shtet” (din ve devle) ose edhe më tutje do të jetë jurisprudencë Islame (fikh) e jo teologji (kelam) i cili do të jetë manifestim tipik i mësimet fetar.” Duke u mbështetur në orientimet ideologjike ekzistuese në botën islame, Karçiçi bëri një ndarje në mes tradicionalizmit, modernizmit Islam dhe revivalizmit. Revivalizmin e quajti si Islam radikal (fundamentalizëm), i cili “paraqet orientimin ideologjik në botën bashkëkohore Islame e cila jep mundin e saj të veçant për ndërtimin e plotë të ideologjisë së njeriut duke u bazuar në mësimet kryesore të mësimet Islam dhe historisë së hershme Islame. “...Përvoja e Bashkësisë së parë Islame në Medine e cila edhe në karakterin normativ paraqet formën e jo shembullin historik për realizimin e Islamit. Andaj islamin e definojmë

si “religjion dhe shtet” ndërsa mundin e tyre e drejtojnë kryesisht në supozime për një rend të tillë shoqëror.”

Dr. Halid Çausheviqi i vetmi prej diskutuesëve bëri një vështrim në aspektin e përdorimit të këtij nocioni në politikën jugoslave dhe qëndrimin e politikës ndaj fundamentalizmit islam: “... Kam vërejtje se në Bosnjë dhe Hercegovinë e cila është zonë multikonfesionale ka qenë e përvetësuar “baraspesha politike” ashtu që kur kritikohet ndonjë bashkjësi fetare ose bashkjësi nacionale, kryesisht bazoheshin në teori simetrike. Kur duheshite të kritikohet një bashkjësi nacionale ose konfesionale, në të njëjtën kohë kritikohet edhe bashkjësia tjetër, pa marrë parasysh se a ka pasur tek ajo shkaqe.” Çausheviqi më pastaj përmendi për fundamentalizmin Islam, në realitet paraqitjen e “urtë” të këtij fundamentalizmi në vitin 1947 duke përkujtuar edhe rastin e “Muslimanëve të ri” në atë kohë duke vlerësuar se ata në mes devotshmërisë treguan edhe agresivitet, por sipas mendimit të tij ishte e “thyer mjaft ashpër”. Ai gjithashtu përmendi edhe “panislamizmin” i cili u paraqit në vitet e gjashtëdhjeta, i cili në të vërtetë ishte kategori e perënduar qysh në vitin 1930 në Kongresin e përgjithshëm Islam në Jerusalem. Sipas Çausheviqit procesi i vitit 1983 nuk i takon një shteti juridik dhe një shoqërije të drejtë. Në lidhje me teorinë paradoksale se nacionalizmi dhe nataliteti shqiptar burojnë nga Islami, ose themel i kanë të bazuara në Islam, është teori e delitantëve islamistë, atëherë pra prej ku buron nataliteti në Amerikën jugore, ose shovenizmi bullgar ndaj një populli të ndershëm maqedonas.”

Kush është kompetent të flasë për fundamentalizmin!

Dr. Zdravko Grebo shprehu kënaqësinë e vetë që i është mundësuar të marrë pjesë në këtë Tryezë duke shtuar se ai nuk është i njohur e as që është kompetent të flasë për një temë të këtillë, mirëpo, marrë nëpërgjithësi, nuk mund t’u largohemi refleksioneve që po paraqiten në këtë nënqiell. “...

Muslimanët vetë duhet të tregojnë kuptimin dhe domethënien e temës në fjalë, por s'pari duhet t'u mundësohet shprehja e fjalës së lirë...”

Dr. Mustafa Ceriq konsideron se fundamentalizmi islam është “inovacion politik i Perëndimit”. Më pastaj përmendi se “atmosfera vis a vis grupeve ekstremiste në botën muslimane pa kurrfarë baze është përcjellë në nënqiellin jugosllav. Besoj se askush prej muslimanëve tonë nuk ka kidnapuar e as që ka marrë pjesë si kamikaz në flotën e 200 marinarëve amerikanë në detrat e Libanit, e kur është fjala për muslimanët tanë askush nuk ka marrë pjesë as në grupet militante.” Procesin e vitit 1983 e quajti si proces politik të montuar. Ai në fund falenderoi dr. Tansakoviçin “për vazin e bukur që e mbajti për dialogun e ndërsjellë” duke thënë se “të njejtin vaz duhet ta mbajë edhe në Beograd dhe – Jeftiqit”. Në vazhdim përmendi se si shkas kryesor i këtij tubimi është libri **“Xhihad”** i dr. M. Jeftiqit të cilin mendim organizatori e gjuajti si të papbazë. Fjala e Ceriqit i dha shkas që të paraqitet Hasan Sushiqi i cili tha se “e di dhe se jam i bindur se motivi i organizatorit nuk është kjo që përmendi dr. Ceriqi, përndryshe nuk do të merrsha pjesë në këtë tubim.”

Si duket fjala e Ceriqit tubimit i dha kahje tjetër andaj deshtepadesht u paraqit edhe dr. Tanaskoviçiqi i cili në mes tjerash tha se nuk është mirë të flasim për ata të cilët nuk marrin pjesë në këtë tubim me arsye ose paarsye...”

Akademiku Muhamed Filipoviç duke u përgjigjur në kërkesën e organizatorit që edhe dëgjuesit të inkuadrohen në bisedë, shfrytëzoi rastin dhe replikoi kundër disa diskutuesëve. Në pika të shkurtëra u përpoq të paraqes gjenezën, dimensionet dhe implikacionet për akuzimin e “fundamentalizmit Islam” tek ne. Në mes tjerash përmendi se vetë ky në vitin 1979 ka qenë i akuzuar si panislamist në tubimin shkencor marksist që është mbajtur në Cavtat. “Atëherë politika e jonë nomenklativë, të shprehem ashtu, nuk ka poseduar nocionin “fundamentalizëm... Unë jam fundamentalist sepse vetë qenia e ime si njeri është e tillë, përndryshe nëse

nuk jam i tillë (fundamentalist) vjen në pyetje qenia njeri – që nënkupton se edhe unë nëse dua të jem njeri, mund të jemë vetëm si i tillë...”

Para se të përfundojmë, njohtojmë lexuesit se nuk është e mundur të përfshihet e tërë ajo që u tha në Tryezën e rrumbullakët për shkaqe objektive. Dhe në fund nëse parashtrohet pyetja se a ka fundamentalizëm Islam në Jugosllavi do të ishte e ngjashme me pyetjen se a ka antisemitizëm, fundamentalizëm orthodox apo katolik në Jugosllavi. Me siguri fundamentalizmi ekziston, por nuk ekziston fundamentalizëm siç e përshkruajmë disa gazetar të shërbimit të politikës ditore në nënqiellin tonë. Andaj lirisht themi se fundamentalizëm në domethënien politike nuk ka mesiguri, ndërsa në kuptim kthim Islamit burimor ekziston dhe patjetër duhet të ekzistojë, përndryshe do të vinte në pyetje vetë jeta e muslimanëve. Fundi i fundit siç ekziston fundamentalizëm në çdo fe, lëvizje, parti ashtu ka edhe në Islam, përndryshe do të injoroheshin burimet e fesë.